



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**VENDIM**  
**Nr. 23 Datë 24.11.2020**

**PËR VERIFIKIMIN E DEKLARIMEVE NË FORMULARIN E VETËDEKLARIMIT TË KANDIDATIT ZJ. TEFTA PETRIT SUFATI NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, PËR KËSHILLIN E BASHKISË GJIROKASTËR, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015 “PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE”**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 e Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neni 11 i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur;

**VËREN**

Me shkresën nr. 8457 prot., datë 28.09.2020, Këshilli i Bashkisë Gjirokastër ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga Këshilltari, zj. Lira Flamur Hilaj, propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 e Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me shkresën nr. 1653/1 prot., datë 14.10.2020, i është drejtuar zj. Anila Bekim Jaubelli, me kërkesë për plotësim dokumentacioni, si kandidat vijues i listës shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për Këshillin e Bashkisë Gjirokastër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit. Kjo kandidatë nuk ka depozituar formularin e vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në bazë të nenit 164 të Kodit Zgjedhor ka proceduar me kandidatin vijues të listës shumëmemërore të subjektit politik, Partia Socialiste e Shqipërisë, Bashkia Gjirokastër, të cilit i kalon mandati i këshilltarit me numër rendor 28, zj. Tefta Petrit Sufati.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në





përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar përcaktuar në bazë të listës shumemërore të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit me numër 0048 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të kandidatit për anëtar zj. Tefta Petrit Sufati, në këshillin e bashkisë Gjirokastër, rezulton se: Në rubrikën I. "TË DHËNA PERSONALE", PIKA B, "Gjenealitete të mëparshme" të Formularit të Vetëdeklarimit, subjekti vetëdeklarues ka deklaruar gjenealitetet e saj dhe është shprehur se ka ndryshuar mbiemrin nga "Tushe" në "Sufati".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, germa "b" dhe pika 3, germa "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 2007 prot., datë 12.11.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 2008 prot., datë 12.11.2020 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Tefta Petrit Sufati, në Këshillin e Bashkisë Gjirokastër, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës tonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Gjirokastër, zj. Tefta Petrit Sufati.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore me shkresën nr. 11650/1 prot., datë 17.11.2020 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar zj. Tefta Petrit Sufati, në këshillin e bashkisë Gjirokastër, e cili rezulton me status e padënuar nga gjykatat shqiptare.

Referuar nenit 49 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" këshilli i bashkisë ka kompetencën për dhënien e mandatit, anëtarit të këshillit bashkiak.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, referuar pikës 2, Kreu V të vendimit nr.17/2016 të Kuvendit konstaton se, për kandidatin për anëtar zj. Tefta Petrit Sufati, në këshillin e bashkisë Gjirokastër, të dhënat e të cilit nuk përbëjnë kusht për mos zgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit, duhet të vazhdojnë procedurat për dhënie mandati nga këshilli i bashkisë Gjirokastër.



## PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, germa “n” dhe pika 2 e Ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; nenin 11 i ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; Kreu V i Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

## VENDOSA:

1. Zj. Tefta Petrit Sufati, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Gjirokastrë, e subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Vazhdimin e procedurave nga këshilli i bashkisë Gjirokastrë, për dhënien e mandatit, kandidatit të listës shumëmemërore zj. Tefta Petrit Sufati, e subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë, për plotësimin e vendit vakant në Këshillin e Bashkisë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative së Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

**Ilirjan CELIBASHI**

